



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 29.3.2022

Dokument parlamentar

Komision përgjegjës

R A P O R T

**PËR AKTIN NORMATIV NR.3, DATË 12.3.2022 “PËR DISA NDRYSHIME DHE
SHTESA NË LIGJIN NR.115/2021 “PËR BUXHETIN E VITIT 2022”**

I. Hyrje.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datave 25 dhe 29 mars 2022, shqyrtoi aktin normativ nr.3, datë 12.3.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”. Akti normativ u shqyrtua sipas rregullave të parashikuara në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relatore, për këtë akt normativ, znj. Pranvera Resulaj.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të ftuar, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë:

- Znj. Delina Ibrahimaj, Ministre;
- Znj. Adela Xhemali, Zëvendësministre;
- Znj. Mimoza Dhëmbi, Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit;
- Z. Ildir Gjata, këshilltar i Kabinetit të Ministres.

II. Baza ligjore.

Akti normativ nr.3, datë 12.3.2022 është paraqitur për miratim nga Këshilli i Ministrave dhe shqyrtohet nga Kuvendi mbështetur në bazën kushtetuese e ligjore, si më poshtë:

- nenet 101 dhe 160 të Kushtetutës;
- nenin 46 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- rregullat e përcaktuara në kreun III të pjesës së dytë të Rregullores së Kuvendit.

Akti normativ shoqërohet me relacionin përkatës, sipas kërkesave të nenit 68 të Rregullores së Kuvendit. Miratimi i tij kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 të Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi dhe përmbajtja e aktit normativ.

III.1. Zhvillimet ekonomike të deritanishme dhe ato të pritshme.

Viti 2021.

Ekonomia shqiptare u rimëkëmb ndjeshëm gjatë vitit 2021, duke tejkaluar nivelin e regjistruar para tërmetit dhe pandemisë Covid-19. Rritja ekonomike ka qenë rreth 7.2 për qind ose 2.8 pikë përqindje më e lartë se parashikimi në muajin qershor 2021.

Në aspektin makroekonomik, rritja ekonomike u favorizua nga stimuli fiskal i dy viteve të fundit, përmirësimi i besimit të konsumatorit, ambienti i favorshëm monetar dhe financiar dhe rritja e kërkesës së huaj. Sektorët kryesorë që mbështetën rritjen ekonomike ishin sektori i ndërtimit dhe aktiviteti i rindërtimit të pasojave të tërmetit.

Rritja ekonomike solli rritjen graduale të punësimit dhe përshpejtimin e ritmit të rritjes së pagave. Të dhënat e INSTAT-it tregojnë se, gjatë tremujorit të katërt të vitit 2021, punësimi u rrit me 2.1 për qind në terma vjetorë, ndërsa paga në sektorin privat u rrit me 10.2 për qind.

Nga vendet e rajonit, Shqipëria në 2021 kishte rritjen e dytë më të lartë pas Malit të Zi (10.8 për qind), ndjekur nga Kosova 7.1 për qind, Serbia 6 për qind, si dhe Bosnjë-Hercegovina dhe Maqedonia e Veriut me nga 4%.

Ndërkohë çmimet e ushqimit dhe të naftës ushtruan presion mbi inflacionin mesatar.

Periudha janar-shkurt 2022.

Gjatë kësaj periudhe u arritën rezultate pozitive në mbledhjen e të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura rezultuan në masën 81.4 miliardë lekë, duke qenë 8 pikë përqindje më shumë ose 6.2 miliardë lekë më të larta se plani 2-mujor. Tejkalmi i të ardhurave u arrit në të të gjithë zërat, si më poshtë:

- *Të ardhurat nga tatimet dhe doganat* u tejkaluan me 7 pikë përqindje ose 3.7 miliardë lekë në krahasim me planin. Këto të ardhura përbëjnë 66 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit.
- *Të ardhurat nga pushteti vendor* u tejkaluan me 22 pikë përqindje ose 1 miliardë lekë në krahasim me planin. Këto të ardhura përbëjnë 6.6 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit.
- *Të ardhurat nga fondet speciale* u tejkaluan me 1 pikë përqindje ose 0.2 miliardë lekë në krahasim me planin. Këto të ardhura përbëjnë 22.6 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit.
- *Të ardhurat jotatimore* u tejkaluan me 14 pikë përqindje ose 0.3 miliardë lekë në krahasim me planin. Këto të ardhura përbëjnë 3.6 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit.

Inflacioni.

Inflacioni i çmimeve të konsumit u rrit respektivisht me 3.7 për qind dhe 3.9 për qind në muajt janar e shkurt dhe pritet të rritet më tej në muajin mars. Kjo rritje e inflacionit është ndikuar nga kriza energjetike dhe agresioni i Rusisë mbi Ukrainën, të cilat sollën rritjen e çmimeve të energjisë elektike, naftës dhe artikujve ushqimorë, si dhe rritjen e kostove të prodhimit e të transportit. Inflacioni pritet të rritet më tej gjatë vitit 2022, ndërsa në vitin 2023 parashikohet të stabilizohet.

III.2. Përmbajtja e aktit normativ.

Qëllimi i aktit normativ nr.3, datë 12.3.2022 është akordimi i mbështetjes buxhetore për sektorin e energjisë elektrike dhe financimi i paketës së rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës.

Akti normativ ka këto karakteristika kryesore:

Së pari, akti normativ ruan të pandryshuar treguesit kryesorë makroekonomikë, si deficitin buxhetor dhe borxhin publik.

Së dyti, të ardhurat e përgjithshme të buxhetit rriten me 10 miliardë lekë. Rritja e të ardhurave mbështetet në ecurinë pozitive të realizimit të tyre gjatë periudhës janar-shkurt 2022 dhe pritshmërive që ky trend të vazhdojë deri në fund të vitit.

E gjithë rritja e të ardhurave parashikohet të sigurohet nga tatimet dhe doganat në zërat si më poshtë:

- TVSH rritet me 7 miliardë lekë;

- Tatimi mbi fitimin rritet me 2 miliardë lekë;
- Akciza rritet me 2 miliardë lekë;
- Tatimi mbi të ardhurat personale rritet me 2 miliardë lekë;
- Taksat nacionale reduktohen me 3 miliardë lekë;

Së treti, shpenzimet e përgjithshme të buxhetit rriten në të njëjtën vlerë me të ardhurat e përgjithshme, 10 miliardë lekë. Nga këto:

Ndryshimet në shpenzimet korrente:

- Parashikohet një mbështetje financiare për sektorin e energjisë elektrike në vlerën 20 miliardë lekë, e cila do të përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave;
- Parashikohet financimi për paketën e rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës në vlerën 6 miliardë lekë. Ky financim do të përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për zbutjen e efekteve të krizës aktuale, për të siguruar mbështetjen e:
 - ✓ Shtresave në nevojë;
 - ✓ Sektorit të transportit publik;
 - ✓ Sektorit të bujqësisë.
- Reduktohen shpenzimet korrente me 5.8 miliardë lekë. Ky reduktim bëhet për të gjitha institucionet buxhetore, duke aplikuar formulën:
 - ✓ Reduktim me 2.5 për qind për shpenzimet e personelit;
 - ✓ Reduktim me 10 për qind për shpenzimet operative, në total, dhe 10 për qind të tjera për shpenzimet e ngushta administrative.

Ndryshimet në shpenzimet kapitale:

Shpenzimet kapitale reduktohen me 10 miliardë lekë në zërat si më poshtë:

- Shpenzimet kapitale për projektet me financim të brendshëm reduktohen me 5.2 miliardë lekë, duke pakësuar shpenzimet në:
 - ✓ Projektet e reja, të cilat nuk janë prokuruar deri tani;
 - ✓ Projektet me natyrë administrative (pajisje zyrash, autovetura etj)
 - ✓ Projektet e infrastrukturës, të cilave u shtyhet afati për zbatim.

- Shpenzimet kapitale për projektet me financim të huaj reduktohen me 4.5 miliardë lekë, duke pakësuar fondet për projektet e reja të infrastrukturës që kanë pritshmëri të ulët realizimi gjatë vitit 2022.

IV. Përputhshmëria e aktit normativ me kushtetutën.

Akti normativ nr.3, datë 12.3.2022 plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 101 të kushtetutës, si dhe të analizuara në vendimin nr.24, datë 10.11.2006 dhe vendimin nr.23, datë 16.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

Nevoja për aktin normativ lindi për të siguruar financimin e sektorit energjitik dhe mbështetjen e shtresave në nevojë në situatën aktuale të rritjes së çmimit të energjisë elektrike, naftës, produkteve ushqimore etj.

Këshilli i Ministrave vlerësoi se këto ndryshime janë të nevojshme dhe urgjente, për të mundësuar vijimësinë e punës së sektorit energjitik dhe për t'u ardhur në ndihmë sa më parë shtresave më të goditura nga rritja e çmimeve. Me qëllim që këto ndryshime të bëheshin realitet, Këshilli i Ministrave vlerësoi domosdoshmërinë e miratimit të tyre me akt normativ. Nëse ndryshimet buxhetore do të propozoheshin me projektligj, do të kërkohej një periudhë më e gjatë për miratimin e tyre dhe do të krijoheshin vonesa në financimet që mundësohen përmes këtij akti normativ. Për këtë arsye, akti normativ plotëson edhe kriterin e urgjencës.

Gjithashtu, akti normativ plotëson edhe kriterin e përkohshmërisë, pasi vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë maksimale prej 45 ditësh, deri në datën e miratimit të tij nga Kuvendi.

V. Diskutimi në Komision.

Znj. Delina Ibrahimaj, Ministre e Financave dhe Ekonomisë, paraqiti aktin normativ dhe nevojën për miratimin e tij. Ajo analizoi zhvillimin ekonomik të vendit gjatë viteve 2013-2019, ku u arrit reduktim i borxhit publik, përsheptim i rritjes ekonomike, rritje e pagës mesatare dhe rritja e PBB për banor. Këta tregues u arritën duke zbatuar parimin “kush fiton më shumë, paguan më shumë”.

Më pas, vendi ynë përballoi me sukses krizat e tërmetit dhe të pandemisë Covid-19, duke rikthyer rritjen ekonomike gjatë vitit 2021. Aktualisht, vendi ynë po përballlet me inflacionin, i cili fillimisht ishte rrjedhë e mospërputhjes midis ofertës dhe kërkesës pas pandemisë, e më pas i agresionit të Rusisë mbi Ukrainën. Rritja e inflacionit u evidentua në rritjen e çmimeve të energjisë elektrike,

hidrokarbureve dhe produkteve ushqimore. Parashikimet janë që inflacioni të rritet edhe më tej gjatë 3- mujorit të dytë e të tretë deri në 4.5 për qind dhe të fillojë të stabilizohet drejt objektivit prej 3 për qind gjatë vitit 2023. Gjithashtu, gjatë vitit 2023 vendi do t'i rikthehet rritjes ekonomike të qëndrueshme prej 4 për qind. Më tej, Ministrja e Financave dhe Ekonomisë paraqiti informacionet respektive për pyetjet e deputetëve.

Znj. Pranvera Resulaj, në cilësinë e relatores, theksoi se akti normativ është shumë i rëndësishëm në situatën aktuale të vështirë që po kalon vendi, si rrjedhojë e rritjes së çmimeve të energjisë elektrike, të hidrokarbureve dhe të artikujve ushqimorë, të ndikuar nga situata politike ndërkombëtare, sulmi ushtarak i Rusisë ndaj Ukrainës. Ky akt normativ krijon mundësitë për financimin dhe vijimin e prodhimit të energjisë elektrike, si dhe mbështetjen e shtresave më vulnerabël të popullsisë përkundëjt fenomenit aktual të rritjes së çmimeve. Akti normativ siguron mbështetje edhe për sektorët më të prekur nga rritja e çmimeve, siç janë transporti publik dhe bujqësia.

Relatorja vlerësoi rezultatet pozitive të arritura nga administratat tatimore e doganore gjatë periudhës 2 mujore të këtij viti, duke rritur të ardhurat e përgjithshme të buxhetit me 8 pikë përqindje më shumë se plani dhe 26 pikë përqindje më shumë se e njejta periudhë e vitit të mëparshëm. Këto rezultate, të cilat priten të jenë pozitive edhe në muajt e ardhshëm, do të shërbejnë si burim i rëndësishëm financimi për politikën mbështetëse sipas aktit normativ. Edhe rialokimi i shpenzimeve, në funksion të politikave mbështetëse dhe prioriteteve që mundëson ky akt normativ, është një masë shumë pozitive në periudhën aktuale.

Gjatë diskutimit, shumica e anëtarëve të Komisionit e mbështetën anktin normativ, ndërsa deputetët e opozitës u shprehën kundër miratimit të tij.

VI. Përfundim.

Duke qenë se akti normativ është në përputhje me kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, si dhe mbështetur në argumentet e mësipërme, Komisioni e miratoi aktin normativ me shumicë votash.

RELATORJA

Pranvera RESULAJ

KRYETARI

Eduard SHALSI